



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE SIGURINË
KIBERNETIKE

RREGULLORE PËR ADMINISTRIMIN E FJALËKALIMEVE
NË RRJETET DHE SISTEMET KOMPJUTERIKE

Miratur me Urdhrin nr 86 , datë 23.08.2019, të Drejtorit
të Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin
Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK)

RREGULLORE PËR ADMINISTRIMIN E FJALËKALIMEVE NË RRJETET DHE SISTEMET
KOMPJUTERIKE

Përmbajtja

1.	HYRJE	1
2.	QËLLIMI	1
3.	FUSHA E ZBATIMIT	1
4.	KËRKESAT E SIGURISË	1
a)	Fjalëkalimet e përdoruesit fundor	1
b)	Fjalëkalimet e sistemeve qendrore dhe administrimit.....	2
c)	Kërkesat për zhvilluesit e aplikacioneve.....	2

RREGULLORE PËR ADMINISTRIMIN E FJALËKALIMEVE NË RRJETET DHE SISTEMET KOMPJUTERIKE

1. HYRJE

Kjo rregullore është hartuar në zbatim të Ligjit Nr. 2 datë 26.01.2017 për “ Sigurinë Kibernetike” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.141, datë 22.02.2019 “ Për Organizimin dhe Funksonimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”

Fjalëkalimet përfaqësojnë mekanizmin primar që mbron sistemet e informacionit nga përdorimi i paautorizuar. Vendosja e fjalëkalimeve të sigurtë dhe sigurimi i menaxhimit efektiv të fjalëkalimeve është çështje thelbësore për sigurinë e sistemeve të informacionit dhe të pajisjeve.

Zgjedhja e fjalëkalimeve të dobëta mund të lejojë shpërndarjen e informacionit tek palët e paautorizuara në burimet e organizatës. Aplikimi i standardeve minimale për vendosjen e fjalëkalimeve mund të zvogëlojë rreziqet e kompromentimit të informacionit.

Kjo rregullore përmban standarde të përgjithshme, të cilat nuk aplikohen për rastet e veçanta kur kërkesat e sigurisë specifikojnë qartë mënyrën se si administrohen fjalëkalimet.

2. QËLLIMI

Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktojë masat minimale për menaxhimin e fjalëkalimeve të pajisjeve dhe sistemeve të informacionit të institucionit. Aplikimi i parregullt i masave ekspozon institucionin ndaj rreziqeve të ndryshme dhe sjell kompromentimin e sistemeve dhe shërbimeve që ato ofrojnë.

3. FUSHA E ZBATIMIT

Kjo rregullore vlen për punonjësit, kontraktorët, konsulentët, punonjësit e përkohshëm ose punonjës të tjerë të institucionit, përfshirë edhe personelin e lidhur me palët e treta. Rregullorja vlen për të gjitha sistemet dhe pajisjet e paklasifikuara të zotëruara ose marrë me qera nga institucioni. Për sistemet e klasifikuara zbatohen rregullat e përcaktuara në VKM nr. 922 datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave.

4. KËRKESAT E SIGURISË

a) Fjalëkalimet e përdoruesit fundor

Kërkesat e sigurisë për fjalëkalimet e përdoruesit fundor përfshijnë:

1. Fjalëkalimi duhet të jetë minimumi 8 karaktere

RREGULLORE PËR ADMINISTRIMIN E FJALËKALIMEVE NË RRJETET DHE SISTEMET KOMPJUTERIKE

2. Fjalëkalimi duhet të përmbajë një kombinim të gërmave kapitale dhe të vogla, numrave dhe karaktereve special (si !, @, #, etj);
3. Fjalëkalimet duhet të ndryshojnë çdo 90 ditë. Në rast kompromentimi të fjalëkalimit ai duhet të ndryshohet menjëherë;
4. 10 Fjalëkalimet e mëparshme nuk mund të përdoren;
5. Fjalëkalimi nuk mund t'u komunikohet të tjerëve, të shkruhet në letër, ose të ruhet në ndonjë *file* ose bazë të dhënash në kompjuter;
6. Fjalëkalimi duhet të jetë i maskuar dhe nuk printohet ose përfshihet kurrë në raporte ose *log-e*;
7. Fjalëkalimi nuk duhet të përmbajë të dhëna personale apo emrin e institucionit;

b) Fjalëkalimet e sistemeve qëndrore dhe administrimit

Kërkesat e sigurisë për fjalëkalimet e tjera ku përfshihen fjalëkalimet e databazave, serverave, firewall-ve, routera, pajisje të ndryshme të rrjetit, etj:

1. Fjalëkalimi duhet të jetë minimumi 10 karaktere;
2. Fjalëkalimi duhet të përmbajë një kombinim të gërmave kapitale dhe të vogla, numrave dhe karaktereve special (si !, @, #, etj);
3. Fjalëkalimet duhet të ndryshojnë çdo 30 ditë, por mund ketë përjashtime. Në rast kompromentimi të fjalëkalimit ai duhet të ndryshohet menjëherë;
4. 15 Fjalëkalimet e mëparshme nuk mund të përdoren;
5. Fjalëkalimi duhet të jetë i maskuar dhe nuk printohet ose përfshihet kurrë në raporte ose *log-e*;
6. Fjalëkalimi nuk duhet të përmbajë të dhëna personale apo emrin e institucionit;
7. Nuk duhet të përdoren karakteret si : (\ , ~ or <)
8. Nuk duhet të përdorën space ose tab.
9. Administratorët e sistemit duhet të ngurtësojnë sistemet e tyre për të penguar tentative të dyshimta për sulme duke përdorur metoda të arsyeshme për të zbutur sulmet me fjalëkalim "forcë brutale". Për shembull, disa sisteme do të bllokojnë një llogari për disa minuta pas disa përpjekjeve të dështuara të identifikimit ose zbulojnë se nga vijnë sulmet dhe bllokojnë përpjekjet e mëtejshme nga ai vend ose në alarm minimal, një alarm në kohë reale që po ndodh një sulm në mënyrë që të ndërmerren veprime manual.
10. Sistemet nuk duhet të konfigurohen për të lejuar hyrjen e përdoruesit pa një fjalëkalim. Administratorët e sistemit duhet që me kohë të rivendosin fjalëkalimet për llogaritë e përdoruesve ose të kërkojnë nga përdoruesit që të rivendosin fjalëkalimet e tyre në situata ku përdorimi i vazhdueshëm i një fjalëkalimi krijon rrezik për akses të paautorizuar në llogari.

c) Kërkesat për zhvilluesit e aplikacioneve

1. Zhvilluesit e aplikacioneve duhet, kur është e mundur, të zhvillojnë aplikacione që kërkojnë protokolle të sigurta për autentikim.
2. Zhvilluesit e aplikacioneve duhet të shmangin krijimin e aplikacioneve që ruajnë fjalëkalimet. Nëse ruajtja e fjalëkalimeve nuk mund të shmanget, zhvilluesit e aplikacioneve duhet të sigurojnë që aplikacionet të mos ruajnë fjalëkalimet në tekst të qartë ose në një format të lehtë të dekriptuar.

RREGULLORE PËR ADMINISTRIMIN E FJALËKALIMEVE NË RRJETET DHE SISTEMET
KOMPJUTERIKE

3. Aplikacionet duhet të mbështesin llogaritë unike të përdoruesit dhe fjalëkalimet në mënyrë që përdoruesit individualë të mos kenë nevojë të ndajnë një fjalëkalim për të përdorur aplikacionin.
4. Në rast të ndryshimit të fjalëkalimit për sistemet kritike dhe të rendësishme, fjalëkalimi i ndryshuar duhet të depozitohet në kasafortë në dhomën e sigurisë në zarf të mbyllur dhe në raste emergjente të hapet me urdhër të titullarit në prani të dy punonjësve.